REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MANUAL PËRDORIMI

# PLATFORMA E KONSULTIMIT PUBLIK

## PLATFORMA PUBLIKE

PËR

Individ, Lobistë, Fondacione, Ekspertë, Grupe Interesi, Shoqata, Organizata Jo Fitimprurëse, Shoqëri Civile dhe Palët e Interesuara.

REALIZUAR NGA
instant

# PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE
2. KONSULTIMET
3. KOMISIONET PARLAMENTARE
4. BURIME
5. NJOFTIME
6. SONDAZHE
7. LLOGARIA PËRDORUESIT
    a. REGJISTRIMI LLOGARISË
    b. PROFILI IM
    c. KOMENTET E MIA
8. KONTAKTO

# 1 PËRMBLEDHJE

Kjo platformë dixhitale lidh Qytetarë, Lobistë, Fondacione, Ekspertë, Grupe Interesi, Shoqata, Organizata Jo Fitimprurëse, Shoqëri Civile dhe palët e interesuara me Kuvendin e Shqipërisë, duke mundësuar komunikim të hapur dhe konsultime mbi projektligjet që prekin të ardhmen e Shqipërisë.

Nëpërmjet kësaj platforme, Kuvendi Shqipërisë mund të mbledhë informacione të vlefshme nga publiku, duke përmirësuar transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset demokratike. Platforma përfshin module të ndryshme si konsultimet, komisionet, sondazhet dhe njoftimet, duke e bërë të lehtë përdorimin dhe ndarjen e informacionit në mënyrë të sigurt dhe të organizuar.



# 2 KONSULTIMET
## HYRJA

Këtu mund të eksploroni dhe të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike të projektligjeve dhe akteve nënligjore. Për të gjetur konsultimet që ju interesojnë, përdorni fushën e kërkimit, zgjidhni komisionin përkatës dhe shtypni “Kërko”. Lista më poshtë ofron akses në materialet dhe detajet e çdo konsultimi të publikuar, duke ju mundësuar të shprehni mendimet dhe komentet tuaja në mënyrë transparente dhe të lehtë për t'u naviguar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

# 2 KONSULTIMET
## PËRMBAJTJA E NJË PROJEKTLIGJI

Këtu mund të eksploroni dhe të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike të projektligjeve dhe akteve nënligjore. Për të gjetur konsultimet që ju interesojnë, përdorni fushën e kërkimit, zgjidhni komisionin përkatës dhe shtypni “Kërko”. Lista më poshtë ofron akses në materialet dhe detajet e çdo konsultimi të publikuar, duke ju mundësuar të shprehni mendimet dhe komentet tuaja në mënyrë transparente dhe të lehtë për t'u naviguar.



# 2 KONSULTIMET
## KOMENTIMI NË NJË PROJEKTLIGJ

Për cdo konsultim të hapur përdoruesit e aprovuar në platformë dhe të kuçur mund të lejnë një koment me mendimet dhe sygjerimet e tyre mbi projekligjin. Komentet lidhen me secilin nen që gjendet në përmbajtjen e projektligjit.

Hapat për të hedhur një koment në një projektligj/nen specifik:
- Hap një konsultimi/projektligj me status “Konsultim i hapur”
- Përzgjidh një nen specifik tek përmbledhja e projektligjit ku dëshiron të lesh një koment
- Kliko butonin “Lini një koment” dhe në çast do hapet një dritare me një fushë ku mund të shkruajmë komentin
- Pasi sigurohemi që kemi shkruar komentin kliko “Publiko” për ta dërguar dhe ruajtur. Në rast se duam të anullojmë këtë veprim përpara se ta publikojmë kliko “Anullo” për të anulluar veprimin.



# 2 KONSULTIMET
## KOMENTIMI NË NJË PROJEKTLIGJ




Pas publikimit të komentit faqja e komenteve do rifreshkohet me komentet e fundit duke përfshirë komentin e hedhur, statusin e komentit, përdoruesin që ka lënë komentin dhe datën e publikimit.




Komentet e reja kalojnë në status “Në pritje” dhe qëndrojnë të publikuara deri në momentin që ndryshohet statusi.

Komentet e përdoruesit gjenden edhe tek faqja “Komentet e mia” me referencat se cilit projektligj dhe nen i përkasin.

## 3 KOMISIONET PARLAMENTARE
PËRMBLEDHJE

Në faqen "Komisionet" shfaqen të gjitha komisionet parlamentare me statistikat përkatëse. Secili Komision mund të hapet për të eksploruar Konsultimet/ Projektligjet e publikuara.




Për të aksesuar komisionet parlamentare të arkivuara në fund të faqes te komisioneve parlamentare kliko "Komisionet e Arkivuara" dhe do ju hapet një faqe me komisionet e arkivuara.



3

# KOMISIONET PARLAMENTARE
## FAQJA E NJË KOMISIONI PARLAMENTAR

Tek faqja e Komisioneve Parlamentare nëse klikon “Shiko konsultimet” do shfaqet një faqe dedikuar vetëm për atë Komision Parlamentar specifik.

Në këtë faqe mund të shfletohen të gjitha konsultimet/projektligjet e publikuara duke patur mundësinë e filtrimit me fjalë kyce ose sipas statusit të konsultimit. Gjithashtu gjenden edhe statistika si numri total i konsultimeve të hapura, të arkivuara, numri total i komenteve apo shikime gjithsej.



# 4 BURIME

Në faqen "Burime" shfaqen të gjitha burimet informuese që ndihmon përdoruesit publik për cdo gjë në lidhje me platformën sic janë:

- Manuale përdorimi
- Artikuj ndihmues
- Lidhje në faqe të tjera jashtë platformës
- Etj.



# 5 NJOFTIME

Njoftime përmban të gjitha njoftimet e fundit në formë artikulli publikuar nga Kuvendi Shqipërisë.



# 6 SONDAZHE

Tek faqja Sondazhe shfaqen sondazhet me pytje dhe përgjigje alternativa ku cdo përdorues i regjistruar mund të marri pjese duke zgjedhur alternativën e tij.

Për të votuar në një sondazh mjafton të klikoni në alternativën që keni përzgjedhur dhe do ju shfaqet një mesazh që votimi juaj u regjistrua me sukses.



7

# LLOGARIA PËRDORUESIT
## REGJISTRIMI LLOGARISË - PLOTËSIMI FORMULARIT

Për të regjistruar një llogari mjafton që përdoruesi të klikojë regjistrohu dhe të ndjeki hapat si në formularin më poshtë.




Regjistrimi kërkon që përdoruesit të plotësojnë të gjitha fushat e detyrueshme të cilat shfaqen me të kuqe gjatë plotësimit të formularit ose pas klikimit të "Regjistro përdorues"

# 7 LLOGARIA PËRDORUESIT
## REGJISTRIMI LLOGARISË - VERIFIKIMI EMAIL-IT

Pas plotësimit të formularit dhe klikimit "Regjistro përdorues", do shfaqet automatikisht një dritare ku mund të plotësoni kodin 6 shifror një përdorim të gjeneruar dhe dërguar në cast tek email që keni plotësuar në formular.




Platforma do ju lajmërojë nëse e keni shkruar gabim apo jo. Pasi është shkruar saktë do merrni një email njoftues për regjistrimin e suksesshëm me adresë email të verifikuar/konfirmuar dhe me emrin e përdoruesit (username) e gjeneruar.

Pasi llogaria juaj është aprovuar nga stafi Kuvendit do merrni një email njoftues tjetër dhe më pas mund të kyceni në platformë dhe të angazhoheni në proceset e konsultimeve.

7

# LLOGARIA PËRDORUESIT
## HYRJA NË LLOGARI

Për tu kycur në llogari mjafton që përdoruesi i regjistruar të klikojë butonin Kycu dhe do shfaqet faqja ku ju kërkohet të plotësoni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin.




Pasi keni hyrë në platformë menuja e përdoruesit lart do shfaqet me opsionet:

- Profili Im
- Komentet e mia
- Dil



7

# LLOGARIA PËRDORUESIT

## RIKUPERIMI I FJALËKALIMIT

Në rast se keni harruar fjalëkalimin mund ta rikuperoni tek faqja “Kycu” duke klikuar “Keni harruar fjalëkalimin?” dhe më pas do ju kërkohet të shkruani emrin e përdoruesit (username) dhe adresën email




Pasi i keni shkruar saktë do ju vijë një email me një link me një përdorim i cili skadon për disa minuta. Kliko linkun dhe do ju hapet një faqe ku ju kërkohet të vendosni fjalëkalimin e ri dy herë.




Kliko “Ruaj” dhe me ruajtjen me sukses ju mund të hyni në llogarinë tuaj me fjalëkalimin e ri.

7

# LLOGARIA PËRDORUESIT
## PROFILI IM

Përdoruesi pasi hap “Profili Im” i shfaqet një formular ku mund të shikojë ose të ndryshojë të dhënat e profilit . Ndryshimi i fjalëkalimit është opsional dhe vetëm në rast se plotësohet do ndryshojë.

Preferencat e njoftimeve të përzgjedhura do ju njoftojnë në email për cdo komision apo njoftime zyrtare të publikuara në platformë.

Për të vepruar me ndryshimet kliko “Ruaj ndryshimet”.


Përshëndetje Ardit Hyka · Profili Im · Komentet e mia · Dil

PLATFORMA KONSULTIMIT PUBLIK

Kryefaqja Komisionet Konsultime Njoftime Burime Sondazhe

Profili im

Përdotëso të dhënat e llogarisë.
– Fushat me sfond gri nuk mund të ndryshohen.

Emri përdoruesit: ardith

Lloji përdoruesit: Individ | Kategoria: Ekspert

Emri: Ardit | Mbiemri: Hyka | Datëlindja: 4 Dhjetor 2007

Numri letërnjoftimit: A11112222A | Gjinia: Mashkull | Adresa:

Email: a3diti@gmail.com | Telefon: 078787111

Ndrysho fjalëkalimin (opsionale)

Fjalëkalimi: Shkruaj fjalëkalimin | Konfirmo fjalëkalimin: Përsërit fjalëkalimin

Duhet patjetër të plotësohen kushtet e sigurisë për fjalëkalimin:
– Minimumi 8 karaktere
– Të përmbajë të paktën 1 gërmë të vogël, 1 gërmë të madhe, 1 numër dhe 1 karakter special
– Të mos jetë i njëjtë me emrin

Preferencat e njoftimeve

Zgjidh kategoritë e interesit për njoftimet

- [ ] Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- [ ] Komisioni për Çështjet Europiane
- [ ] Komisioni për Politikën e Jashtme
- [ ] Komisioni për Sigurinë Kombëtare
- [ ] Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- [ ] Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
- [x] Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- [x] Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
- [x] Administrata dhe Të Tjera
- [x] Njoftimet e fundit

Vini re: Çdo ndryshim i të dhënave të përdoruesit është i monitoruar

Ruaj ndryshimet

Shkarko raport mbi aktivitetin tim në platformë

Shkarko raport

Përdoruesi i jepet mundësia të shkarkojë raportin mbi aktivitetin e vetë në platformë në format CSV/Excel  duke klikuar “Shkarko raport”.

7

# LLOGARIA PËRDORUESIT
## KOMENTET E MIA

Për të gjetur të gjitha komentet që ke lënë në platformë hap “Komentet e mia” tek menuja përdoruesit.

Aty gjenden komentet e fundit të publikuara më të dhëna si:

- numri komenteve total që kam publikuar
- të dhënat e secilit koment si:
    - referenca me projektligjin/konsultimin
    - neni përkatës
    - data e publikimit
    - statusi komentit
    - dhe arsyetimi nëse ka




Lista komenteve mund të shfletohet në disa faqe dhe i shërben përdoruesit të gjurmoj cdo koment që ka hedhur në platformë. Gjithashtu si përdorues mund të marrësh edhe email njoftuese në raste ndryshim statusi nga moderatorët.

# 8 KONTAKTO

Për të kontaktuar mjafton të dërgoni email në adresën e koordinatorit ose të plotësoni formularin e faqes të Kontaktit

